



**Instituti i Trashëgimisë
Shpirtërore e Kulturore të
Shqiptarëve – Shkup**



**Qendra e Studimeve dhe Publikimeve
për Arbëreshët (QSPA)**

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

ndërmjet:

**INSTITUTIT TË TRASHËGIMIGË SHPIRTËRORE E
KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP**

Dhe

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët

QENDRËS SË STUDIMEVE DHE PUBLIKIMEVE PËR ARBËRESHËT

I. TË DHËNA PËR NËNSHKRUESIT:

2. Instituti i Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve – Shkup (në tekstin e mëtejshëm ITSHKSH) është institucion i lartë shkencor, arsimor e kulturor, i themeluar në vitin 2007. Në bazë të Statutit të tij, ITSHKSH merret me hulumtimin, identifikimin, studimin dhe sistematizimin e trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve në Maqedoni, me të kaluarën historike të shqiptarëve dhe me krijimtarinë kulturore të krijuar ndër shekuj në këto anë. Si i këtillë, ITSHKSH e zhvillon veprimtarinë e tij në ruajtjen, studimin dhe kultivimin e kësaj trashëgimie, duke ndikuar kështu që kjo mos të tjetërsohet, harrohet e shkatërrohet.

2. Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (në tekstin e mëtejshëm QSPA) ka mision studimet e specializuara për historinë, letërsinë dhe kulturën e komunitetit arbëresh, nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit mes studiuesve të fushës vendas dhe në diasporë e më gjerë, me qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e strukturës së studimeve mbi komunitetin arbëresh. Pjesë e misionit të Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) është vlerësimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me komunitet arbëresh në botë, përmes organizimit të aktiviteteve dhe konferencave shkencore.

II. LËNDA E TRAJTIMIT

Lënda e trajtimit e këtij Memorandumi është bashkëpunimi ndërmjet ITSHKSH-së dhe QSPA-së në fushën e shkencës, kulturës dhe promovimit të përbashkët të aktiviteteve.

III. QËLLIMI I KËTIJ MEMORANDUMI

Qëllimi i këtij Memorandumi është bashkëpunimi për sigurimin e kushteve të përshtatshme dhe të mundshme për ushtrimin e veprimtarive të ndryshme në fushën e shkencës, kulturës dhe promovimit të përbashkët të aktiviteteve.

IV. SYNIMET

- Bashkëpunimi dhe ndihma e ndërsjellë në fusha me interes të përbashkët, siç është zhvillimi i përvojave shkencore e kulturore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në Republikën e Shqipërisë;
- Botimi i përbashkët i veprave shkencore me interes për të dy palët, që në fokus kanë historinë, kulturën, gjuhën, letërsinë dhe folklorin arbëresh dhe të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. Ato do të kenë në fokus cilësimin e identitetit të komunitetit arbëresh dhe të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, si pjesë e shkencës albanologjike, por edhe rivlerësimin e marrëdhënieve të vendlindjes me komunitetin arbëresh, si komunitet shqiptar më i vjetër në diasporë.

- Në funksion të bashkëpunimit, dy institucionet do të shkëmbejnë fondet arkivore të dokumenteve historike. Dokumentet do të përdoren për realizimin e projekteve shkencore për çështjen shqiptare.
- Sensibilizimi i opinionit më të gjerë për nevojën e kultivimit dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore e shpirtërore si pasuri kombëtare;
- Promovimi dhe ruajtja e vlerave shpirtërore e kulturore me interes të përbashkët;
- Krijimi i klimës së mirë që kuadrot e reja të inkuadrohen në projektet shkencore që i realizon ITSHKSH-ja e QSPA, ndërsa mund të jenë ndihmesë e mirë e ndërsjellë.

V. KUSHTET

Palët nënshkruese të këtij Memorandumi, detyrohen që të studiojnë dhe gjejnë mënyra dhe mundësitë për inicimin e jetësimit të projekteve të ndryshme me interes të ndërsjellë.

VI. DETAJET E MEMORANDUMIT

Palët nënshkruese të këtij memorandumi bien dakord që projektet me interes të ndërsjellë të zbatohen në bazë të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit reciprok.

VIII. PËRFUNDIMI DHE IMPLEMENTIMI I MEMORANDUMIT

Për çdo projekt të përbashkët në të ardhmen, që do të realizohet mbi bazë të këtij memorandumi, palët bien dakord, duke i detajuar të drejtat dhe detyrimet.

Çfarëdo mosmarrëveshje që do të paraqitet në lidhje me interpretimet e këtij memorandumi, palët bien dakord që ato t'i zgjidhin përmes dialogut të ndërsjellë.

Çdo ndryshim i këtij memorandumi do të bëhet vetëm me pëlqim të të dy palëve.

Memorandumi është hartuar në gjuhën shqipe, në katër (4) ekzemplarë identikë: dy (2) për administratën e Institutit të Trashëgimisë Kulturore dhe Shpirtërore të Shqiptarëve – Shkup dhe dy për administratën e Qendrës për Studimin dhe Publikimin për Arbëreshët.

Memorandumi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit prej të dy palëve.

Nënshkruar në Shkup , më ____ .06.2021.

**Për Institutin e Trashëgimisë
Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup**

DREJTOR

Dr. Skender Asani

**Qendra e Studimeve dhe Publikimeve
për Arbëreshët (QSPA)**

DREJTOR EKZEKUTIV

Diana Kastrati